

## TERMAT E KONTRATËS

Termat e marrëveshjes kërkojnë që një operator të ndërtojë një rrugë – ta përfundojë ndërtimin brenda dy vitesh – dhe pastaj ta mirëmbajë dhe shfrytëzojë me një standard të caktuar për tetë vite (nga viti 3 – 10). Termat e marrëveshjes kërkojnë gjithashtu që operatori të riasfaltojë rrugën kur asfaltimi i parë të ketë humbur cilësinë nën një standard të kërkuar. Operatori vlerëson se një gjë e tillë duhet bërë në fund të vitit të tetë. Në fund të vitit të 10-të marrëveshja e shërbimit mbaron. Supozojmë se operatori identifikon një detyrim të vetëm performance për shërbimet e ndërtimit. Operatori vlerëson se kostot që ai do të përballojë për të mbyllur detyrimin janë:

### Kostot e kontratës

	Viti	Shuma
Shërbimet e ndërtimit	1	500
“ “	2	500
Shërbimi i shfrytëzimit	3 – 10	10
Riasfaltimi i rrugës	8	100

Termat e marrëveshjes lejojnë operatorin të mbledhë “pagesat e rrugës nga shoferët”, vlerësuar kjo me 200 (njësi) në vit, në vitet 3 – 10, duke supozuar se numri i mjeteve në qarkullim në këtë rrugë do të mbetet konstant në këto vite. Marrëveshja gjithashtu parashikon që koncesiondhënësi rimbursos operatorin në fund të vitit të 8-të për shpenzimet e riasfaltimit në vlerën 100 njësi. Supozohet gjithashtu se operatori i siguron fondet e nevojshme përmes një huaje bankare me interes 6.7%<sup>1</sup>.

## AKTIV AFATGJATË JOMATERIAL

Operatori i ofron koncesiondhënësit shërbimin e ndërtimit në këmbim të një aktivi jomaterial, konkretisht të drejtës për të arkëtuar pagesat e rrugës nga drejtuesit e mjeteve, përgjatë viteve 3 – 10. Operatori e mat aktivin jomaterial me vlerën e drejtë. Vlera e drejtë përcaktohet indirekt duke i'u referuar çmimit të shërbimeve të ofruara të ndërtimit. Operatori vlerëson se çmimi i këtyre shërbimeve është 5% mbi koston e ndërtimit, si një normë që do të kërkohej si kompensim i ofrimit të këtyre shërbimeve nga pjesëmarrësit e tjerë në këtë treg duke përfshirë edhe riskun që shoqëron kostot e ndërtimit. Në këtë shembull gjithashtu është supozuar se operatori i kapitalizon kostot e huamarrjes të vlerësuar 6.7% përgjatë fazës së ndërtimit (*Kujdes! Sipas SKK 5 kostot e huamarrjes trajtohen si shpenzime periudhe*).

<sup>1</sup> Nuk llogariten interesa për vitin e parë duke supozuar që huaja arkëtohet në fund të vitit

**Tabela 1. Matja fillestare e aktivitet jomaterial**

Zërat e kostos	Njësi monetare
Shërbimet e ndërtimit në vitin I	525
Kapitalizimi i kostos së huamarrjes	34
Shërbimet e ndërtimit në vitin II	525
Aktivi jomaterial në fund të vitit II	1.084

Sipas SKK 5, AAJM amortizohen në bazë sistematike gjatë jetës së të dobishme. Shuma e amortizueshme (1.084 njësi monetare) do të shpërndahet në mënyrë lineare për vitet 3 – 10, pra shpenzimi vjetor i amortizimit do të jetë  $1.084 / 8 = 135$  në vit.

#### **Kostot dhe të ardhurat e ndërtimit**

Kostot e ndërtimit janë 500 njësi në vit, të ardhurat nga ndërtimi janë 525 njësi në vit (marzhi 5%), pra fitimi nga ndërtimi 25 njësi në vit.

#### **Të ardhurat nga pagesat e rrugës**

Përdoruesit e rrugës paguajnë për shërbimin publik në të njëjtin moment kur e përfitojnë atë. Pra operatori njih të ardhurat nga pagesat për rrugën kur i mbledh / arkëton ato.

#### **Detyrimet e riasfaltimit**

Detyrimi i operatorit për riasfaltimin vjen si pasojë e shfrytëzimit të rrugës gjatë afatit të kontratës. Ky detyrim njihet dhe matet sipas SKK 6 “Provizionet, detyrimet dhe aktivitet e kushtëzuara”, pra me vlerësimin më të mirë të shumës së kërkuar për përmbushjen e detyrimit aktual në fund të periudhës raportuese. Për qëllime të ushtrimit supozohet se termat e kontratës koncesionare janë të tilla që vlerësimi më i mirë i shumës së nevojshme për shlyerjen e detyrimit në atë datë llogaritet në proporcion me numrin e mjeteve të transportit që kanë përdorur rrugën deri në atë datë. Kjo shumë rritet maksimumi deri në 17 njësi monetare çdo vit. Shuma e parashikuar e provizionit skontohe për periudha më të hershme me një normë të parashikuar në kontratë (supozohet 6%).

**Tabela 2. Detyrimet e riasfaltimit**

Viti	3	4	5	6	7	8	Totali
Detyrimi vjetor (skontuar me 6%)	12	13	14	15	16	17	87
Rritja e detyrimit në kohë	0	1	1	2	4	5	13
Shpenzimi i provizionit	12	14	15	17	20	22	100

## INFORMACION PËRMBLEDHËS NGA PASQYRAT FINANCIARE

**Tabela 3. Fluksi i mjeteve monetare**

Viti	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	TOT
Arkëtime	-	-	200	200	200	200	200	200	200	200	1.600
Kosto kontrate	(500)	(500)	(10)	(10)	(10)	(10)	(10)	(110)	(10)	(10)	(1.180)
Kosto huamarrje	-	(34)	(69)	(61)	(53)	(43)	(33)	(23)	(19)	(7)	(342)
Flukse neto	(500)	(534)	121	129	137	147	157	67	171	183	78

**Tabela 4. Të ardhurat gjithëpërfshirëse**

Viti	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	TOT
Të ardhura	525	525	200	200	200	200	200	200	200	200	2.650
Amortizimi	-	-	(135)	(135)	(135)	(135)	(135)	(135)	(135)	(135)	(1.084)
Riasfaltimi	-	-	(12)	(14)	(15)	(17)	(20)	(22)	-	-	(100)
Kosto kontrate	(500)	(500)	(10)	(10)	(10)	(10)	(10)	(10)	(10)	(10)	(1.080)
Kosto huamarrje	-	-	(69)	(61)	(53)	(43)	(33)	(23)	(19)	(7)	(308)
Fitimi neto	25	25	(26)	(20)	(14)	(6)	1	9	36	48	78

**Tabela 5. Pozicioni financiar**

Fundi vitit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Aktivi jomaterial	525	1.084	949	814	678	542	406	270	135	-
Mjetet monetare / (borxhi)	(500)	(1.034)	(913)	(784)	(647)	(500)	(343)	(276)	(105)	78
Detyrimi riasfaltimit	-	-	(12)	(26)	(41)	(58)	(78)	-	-	-
Aktive neto	25	50	24	4	(10)	(16)	(15)	(6)	30	78

<b>PJESË NGA DITARI I KONTABILITETIT</b>			
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i veprimit</b>	<b>DEBI</b>	<b>KREDI</b>
	VITI I-rë		
1	Banka	500	
	Hua		500
2	Shpenzime ndërtimi	500	
	Banka		500
3	Aktive Jomateriale	525	
	Të ardhura nga koncesioni		525
	VITI II-të		
4	Banka	500	
	Hua		500
5	Shpenzime ndërtimi	500	
	Banka		500
6	Aktive Jomateriale	525	
	Të ardhura nga koncesioni		525
7	Aktive Jomateriale	34	
	Hua		34
	VITI III-të		
8	Banka	200	
	Të ardhura nga tarifimi		200
9	Shpenzime amortizimi	135	
	Amortizimi i akumuluar (AAJM)		135
10	Shpenzime provizioni për riasfaltim	12	
	Detyrime provizioni		12
11	Shpenzime mirëmbajtje	10	
	Banka		10
12	Shpenzime interesi (1.034 * 6.7%)	69	
	Hua		69
13	Hua	190	
	Banka		190
	VITI IV-rt		
14	Banka	200	
	Të ardhura nga tarifimi		200
15	Shpenzime amortizimi	135	
	Amortizimi i akumuluar (AAJM)		135
16	Shpenzime provizioni për riasfaltim	14	
	Detyrime provizioni		14
17	Shpenzime mirëmbajtje	10	
	Banka		10

18	Shpenzime interesi (913 * 6.7%)	61	
	Hua		61
19	Hua	190	
	Banka		190
	VITI V-të		
20	Banka	200	
	Të ardhura nga tarifimi		200
21	Shpenzime amortizimi	136	
	Amortizimi i akumuluar (AAJM)		136
22	Shpenzime provizioni për riasfaltim	15	
	Detyrime provizioni		15
23	Shpenzime mirëmbajtje	10	
	Banka		10
24	Shpenzime interesi (784 * 6.7%)	53	
	Hua		53
25	Hua	190	
	Banka		190
	VITI VI-të		
26	Banka	200	
	Të ardhura nga tarifimi		200
27	Shpenzime amortizimi	136	
	Amortizimi i akumuluar (AAJM)		136
28	Shpenzime provizioni për riasfaltim	17	
	Detyrime provizioni		17
29	Shpenzime mirëmbajtje	10	
	Banka		10
30	Shpenzime interesi (647 * 6.7%)	43	
	Hua		43
31	Hua	190	
	Banka		190
	VITI VII-të		
32	Banka	200	
	Të ardhura nga tarifimi		200
33	Shpenzime amortizimi	136	
	Amortizimi i akumuluar (AAJM)		136
34	Shpenzime provizioni për riasfaltim	20	
	Detyrime provizioni		20
35	Shpenzime mirëmbajtje	10	
	Banka		10
36	Shpenzime interesi (500 * 6.7%)	33	
	Hua		33
37	Hua	190	

	Banka		190
	VITI VIII-të		
38	Banka	200	
	Të ardhura nga tarifimi		200
39	Shpenzime amortizimi	136	
	Amortizimi i akumuluar (AAJM)		136
40	Shpenzime provizioni për riasfaltim	22	
	Detyrime provizioni		22
41	Shpenzime mirëmbajtje	10	
	Banka		10
42	Shpenzime interesi (343 * 6.7%)	23	
	Hua		23
43	Hua	90	
	Banka		90
44	Detyrime provizioni	100	
	Banka		100
	VITI IX-të		
45	Banka	200	
	Të ardhura nga tarifimi		200
46	Shpenzime amortizimi	135	
	Amortizimi i akumuluar (AAJM)		135
47	Shpenzime mirëmbajtje	10	
	Banka		10
48	Shpenzime interesi (276 * 6.7%)	19	
	Hua		19
49	Hua	190	
	Banka		190
	VITI X-të		
50	Banka	200	
	Të ardhura nga tarifimi		200
51	Shpenzime amortizimi	135	
	Amortizimi i akumuluar (AAJM)		135
52	Shpenzime mirëmbajtje	10	
	Banka		10
53	Shpenzime interesi (105 * 6.7%)	7	
	Hua		7
54	Hua	112	
	Banka		112